

**VENDIM**  
**Nr. 164, datë 12.10.2017**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EUROBIZNES” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET: “LUSEN 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.315 MW; “LUSEN 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; “LUSEN 3”, ME FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; DHE ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 1.515 MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, germa “a”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k., si dhe informacionin shtesë të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 mw; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 mw,

konstatoi se:

- ERE me vendimin nr. 130, datë 16.8.2017, filloi procedurat për licencimin e shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 mw; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 mw.

- Në vendimin sipërcituar është konstatuar dhe lënë detyrë për aplikuesin që: Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me nenin 9, pika 4.1.3, germa “c”, shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000 dhe germa “d” - nenin 9, pika 4.1.5, germa “a”, miratimi i pikës së lidhjes dhe germa “b”, leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

- Shoqëria “Eurobiznes” sh.p.k. rezultoi se plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Eurobiznes” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga

HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 mw; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**